



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05-138

Dt. 16.03.2021

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit, shpallë:

Konkurs për plotësimin e vendeve të punës

Pozita: Punëtor teknik – pastrues

- ShFMU " Sami Frashëri " Zhiti (një punëtor/e teknik/e)
- ShFMU " Shefki Latifi" Pollatë (një punëtor/e teknik/e) , me kohë të caktuar deri më 31.08.2021

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit (me mundësi vazhdimi)

Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruaj mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lendeve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës, t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për sanimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për sanimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:


- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin;
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatet të cilët pranohen pas publikimit të rezultateve).

Afati i konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 dite kalendarike, nga dita e shpalljes se konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 30.03.2021.



Drejtori
Avni Fetahu